



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:248562

Datë: 30.12.2020

Numri i dokumentit: 01383102

PKR.nr. 174/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti për Krime të Rënda, trupit gjykues i përbërë nga gjyqtarët: Islam Thaçi kryetar, Aziz Shaqiri dhe Milorad Mitkoviç anëtarë, me zyrtaren ligjore Zahide Rexhepi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarëve: S. M., për shkak të veprës penale, keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1, nënparagrafi 2.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, të cilin e ka mbrojtur, av. ...nga Gjilani, i caktuar sipas detyrës zyrtare, Z. S., S. S. dhe M. P., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 lidhur me paragrafin 1 e nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarin Z. S. e ka mbrojtur av.... nga Gjilani, e caktuar sipas detyrës zyrtare, ndërsa të akuzuaren N. P., e ka mbrojtur av.... nga Viti me autorizim, si dhe E. A., për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër, PP.I.nr.194/2015, të datës 22.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik të mbajtur më 26.11.2020, në prani të Prokurorit të Shtetit Arben Kadriu, përfaqësuesit të të dëmtuarës, Komunës së Kllokotit, D. V., të të akuzuarëve si dhe mbrojtësve të tyre, më datën 01.12.2020, publikisht shpalli, ndërsa më 21.12.2020, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. S. M., me pseudonimin “..”, nga babai D.dhe nëna B.,e lindur V., i lindur me dt. ..., në ..., ndërsa me vendbanim të përhershëm në ..., ka të kryer Fakultetitin ... , aktualisht është ..., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës dhe Serbisë, më parë i pa dënuar,.....

2.Z.S., me pseudonim “...”, nga babai A. dhe nëna V., e lindur A., i lindur me dt. ... në fshatin ..., komuna e Vitisë, ku edhe jeton, ka të kryer Fakultetitin ..., i pa punësuar, më parë i punësuar në ...,si Zyrtar për ..., baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar.

3.S. S., me pseudonimin” .”, nga babai D. dhe nëna D., e lindur T., i lindur me dt. ..., në Viti, ndërsa me vendbanim në ..., ka të kryer ..., i pa punësuar ,më parë i punësuar , ..., i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar.

4. N. P., nga babai Z. dhe nëna T., e lindur T., e lindur me dt. .. në fshatin ..., Komuna e Ferizajit, tani me vendbanim në fshatin .., Komuna e Vitisë, ka të kryer ..., aktualisht është ..., e martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, më parë e pa dënuar.

5. E. A., nga babai S. dhe e ëma N. e lindur Z., i lindur me dt. ... në fshatin .., ka të kryer shkollën e lartë, i martuar, babë i tre fëmijëve, pronar i firmës "... në fsh...", i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar.

JANË FAJTORË

I

Sepse:

I akuzuari S. M., në cilësinë e ..., duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin e tij zyrtar, me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për vete apo për personin tjetër, apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër, me dashje ka tejkalluar kompetencat dhe ka shkelur detyrat e tij të domosdoshme të përcaktuara me ligj, në atë mënyrë që edhe pse e ka ditur se inventarimobilet për zyre të specifikuar sipas kontratës me numër 2863/ 1 të datës 05.12.2012, të lidhur në mes Komunës së Klllokotit dhe firmës ... me pronar të pandehurin E. A., nuk ka arritur fare në komunë, i njëjti nxjerr vendim për formimin e komisionit me nr. 2890/ 1, të datës 14.12.2012, për pranimin e inventarit komunal, anëtarët e komisionit i fton në zyrën e tij dhe duke keqpërdorur autoritetin, ushtron ndikim te antarët e komisionit për hartimin e raportit, kinse inventari është dorëzuar në komunë nga ana e kontraktuesit, komisioni përpilon dhe nënshkruan raportin për pranim, me ç'rast nga fshehja e gjendjes reale, lidhur me mos përmbushjen e kontratës, e dëmton buxhetin e komunës në vlerë prej 29.330.00 euro, përkatësisht kontrata përmbushet në tërësi por me vonesë të theksuar edhe atë përfundimisht me datën 14.02.2019, duke mbetur akoma dëmi material i shkaktuar, për shkak të kësaj vonese në shumën prej **2,790.84 euro**.

Me çka ka kryer veprën penale, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.

II

Të akuzuarit: Z. S., S. S. dhe N. P.:

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit për pranimin e inventarit të Komunës së Klllokotit, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, në bashkëkryerje, me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, apo t'i shkaktojnë dëm personit tjetër, me dashje, kanë shkelur detyrat e tyre të domosdoshme të përcaktuara me ligj, duke ndërmarr veprimet zyrtare të nevojshme që kanë qenë të detyruara t'i ndërmarrin si komision për pranimin e inventarit të komunës, sipas vendimit 2890/1, të dt. 14.12.2012, për vërtetim të drejtë të gjendjes reale, lidhur me përmbushjen e kontratës në mes Komunës së Klllokotit dhe firmës NTP ..., ashtu që më datë 17.12.2012 përpilojnë dhe nënshkruajnë një raport me numër 2897/ 1 për pranimin e mobileve për zyra se kinse të njëjtin e kanë pranuar, dhe se Ministria e Pushtetit Lokal mund ta bëjë pagesën për porosinë e inventarit komunal, përkundër faktit që materiali nuk ishte pranuar fare, me çka Komunën e Klllokotit, e kanë dëmtuar në vlerë prej **29.330.00 euro**, përkatësisht kontrata përmbushet në tërësi, por me vonesë të theksuar edhe atë përfundimisht me datën 14.02.2019, duke mbetur akoma dëmi material i shkaktuar për shkak të kësaj vonese në shumën prej **2,790.84 Euro**.

Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

III

I akuzuari E. A.:

Në cilësinë e pronarit të firmës N.T.P... me seli në fshatin .., Komuna e Vitisë, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, ka tejkalluar kompetencat e tij zyrtare, me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër, ashtu që më datë 17.12.2012, edhe përkundër faktit se inventarin komunal nuk e kishte dërguar fare në komunë, i njëjti ka përpiluar faturën me numër 138/ 12, kinse në tërësi është përmbushur kontrata me numër 2863/1, e datës 05 .12. 2012, e fituar në tenderin sipas konkursit, KI 660 12 025 121, e që për pasojë nga Ministria e Pushtetit Lokal, i kryhet pagesa nga Komuna e Kllokotit në vlerë prej 29.330.00 Euro, ashtu që për mjetet monetare në lartësinë e tillë të mbajtura deri më datën 19.02.2019, kur edhe e ka përmbushur shumën e kontratës lëndore në tërësi, komunës në fjalë i ka shkaktuar dëm material në shumën prej **2,790.84 Euro**.

Me çka ka kryer veprën penale, keqpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK-së.

Andaj, gjykta duke u bazuar në dispozitat e sipërtheksuara ligjore si dhe neneve: 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, e lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarit, i

G J Y K O N

Të akuzuarin S. M., për veprën penale **dispozitivi I**, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve, të cilin do ta mbajë pasi aktgjykimi të bëhet i plotëfuqishëm.

Të akuzuarit: Z. S., S. S. dhe N. P., për veprën penale **dispozitivi II**, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve, të cilin do ta mbajnë pasi aktgjykimi të bëhet i plotëfuqishëm.

Të akuzuarin E. A., për veprën penale **dispozitivi III**, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve, të cilin do ta mbajë pasi aktgjykimi të bëhet i plotëfuqishëm.

Detyrohen të akuzuarit : S. M., Z. S., S. S., N. P. dhe E. A., që në mënyrë solidare, Komunes së Kllokotit t'ia paguajnë shumën prej **2.790.84 Euro**, të shkaktuara me veprën penale të keqpërdorimit të pozitës ose autoritetit zyrtar si në pikat **I, II, dhe III**, të aktakuzës, tani aktgjykimit edhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Detyrohen të akuzuarit e sipërtheksuar që secili prej tyre veq e veq, të paguajnë shpenzimet e procedurës, përkatësisht paushallin gjyqësorë në shumë prej nga 50 euro, si dhe shumën prej 50 euro, në emër të taksës për kompenzimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, me datë 24.12.2015, ka ngritur aktakuzën, PP.I.nr. 194/2015, të datës 22.12.2015, kundër të akuzuarëve: S.M.për shkak të veprës penale, keqpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, Z.S., S.S. dhe M.P., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 lidhur me paragrafin 1 e nenin 31 të KPRK-së, si dhe E.A. për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK-së.

Gjykata pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor të akuzuarit e sipërtheksuar me aktgjykimin PKR.nr.9/2016 të dt.15.05.2019, i ka liruar nga akuza.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.346/19 të dt.18.10.2019, ka aprovuar ankesën e prokurorit të PTHDKR, PPI.nr.194/2015 e dt.31.05.2019, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan -Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.9/2016 të dt.15.05.2019, e ka anuluar dhe lënda është kthyer të njejtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me datat: 02.11.2020 dhe 26.11.2020, në të cilat kanë prezentuar prokurori i shtetit Arben Kadriu, të akuzuarit S.M. me mbrojtësin av... nga Gjilani, i caktuar sipas detyrës zyrtare, Z.S. me mbrojtësin av..., e caktuar sipas detyrës zyrtare, N. P. me mbrojtësin, av... me autorizim, të akuzuarit S. S. dhe E. A., të cilët kanë deklaruar se do të mbrohen vet gjegjësisht kanë hequr dorë nga e drejta për të pasur mbrojtës, si dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës, Komunës së Klllokotit, D.V..

2. Provat e administruara

Gjendjen faktike të cekur si më lartë, gjykata e vërtetoi duke u bazuar në këto prova: Deklaratat e dëshmitarëve: N. N., S.T., P.R., A.S. si dhe eksperti financiar Ibrahim Tahiri, procesverbali i komisionit për verifikimin e gjendjes faktike të inventarit të Komunës së Klllokotit, të furnizuar nga ana e firmës “..” nga Pozhorani me nr.6437/3, më datë 09.10.2015, vendimi për formimin e komisionit nga ana e ish-kryetarit të Komunës së Klllokotit, tani të akuzuarit S. M., me nr. 2890/1 e datës 14.10.2012, raporti për pranimin e inventarit me nr.2897/1 i datës 17.10.2012, kontrata me nr.2863/1 e datës 05.12.2012, e lidhur në mes Komunës së Klllokotit dhe NTP “...”, specifikacioni i materialit për zyre, kërkesa nga NTP ., drejtuar zyrës së prokurimit dhe kryetarit e protokuluar me nr.6615/e datës 30.11.2015, fatura me nr.138/12 e datës 17.12.2015, vendimi për formimin e komisionit, për vërtetimin e gjendjes faktike në NTP “..” me nr.6617/1 i datës 30.11.2015, njoftimi për vizitë në firmën “..” nga ana e komisionit me nr.6631/3 i datës 01.12.2015, drejtuar të akuzuarit E. A., njoftimi nga i akuzuari E. A., përmes email adresës, drejtuar Kryetarit të Komunës, me datë 03.12.2015, raporti i komisionit për vërtetimin e gjendjes faktike për kontrollimin e inventarit në NTP “..” në Pozhoran, sipas faturës, nr.138/12, me nr,6645/3, i datës 04.12.2015, ekspertiza financiare sipas lëndës, PKR.nr. 9/2016 e datës 17.07.2018 dhe ekspertiza financiare plotësuese për lëndën e njejtë e hartuar nga eksperti financiar e datës 17.01.2019, si dhe procesverbali i datës 14.02.2019, hartuar nga ana e operatorit teknik NTP “..” në Pozhoran, në njëjërën anë dhe komisionit të Komunës së Klllokotit, i formuar nga kryetari i Komunës së Klllokotit me nr.297/1 më datë 21.02.2019, lidhur me praninë dorëzimin e inventarit-për zyre, pjesës së mbetur të inventarit për objektin e Komunës së Klllokotit.

Deklaratat e dëshmitarëve:

Dëshmitari N. N. ka deklaruar: unë kam punuar si drejtor i buxhetit të financave dhe zhvillimit ekonomik, gjatë periudhës kohore derisa sa kam punuar në Komunën e Kllkotit, unë jam ai që kam parashtruar kallxim penal ndaj S.M., dhe jam i njohur lidhur me rastin në fjalë. Komuna e Kllkotit ka pasur kontratë në vitin 2013, për furnizim me inventar, ajo dosje ka qenë në zyrën e prokurimit të komunës, por lënda ka qenë edhe në zyrën e financave. Gjatë kohës sa kam qenë unë drejtor i BFZHE nuk është bërë furnizimi me material sipas kontratës, kemi lidhur një kontratë të re për furnizim për inventar për ndërtesën e komunës, me një firmë nga Ferizaji emri nuk më kujtohet. Furnizimi është kryer në kompaninë nga Ferizaji. Që në fillim ish-kryetari i komunës S. S. e ka ftuar përfaqësuesin e firmës “.” në lidhje me furnizimin me inventar, sipas kontratës së mëparshme dhe se përfaqësuesi i kompanisë i ka premtuar kryetarit se do ta furnizoj me inventar, përfaqësuesi i kompanisë ka qenë E., pas kësaj inventari nuk ka arritur, kështu që kryetari i komunës apo drejtori i administratës e kanë formuar një komision i cili ka qenë i obliguar për verifikimin e inventarit edhe atë se a ka mbërritur inventari, a ekziston apo jo. Komisioni me sa e di unë ka qenë edhe në teren te firma “..” për të verifikuar se a ekziston inventari në depo apo jo dhe me sa e di unë komisioni nuk ka gjetur asgjë. Anëtarë të komisionit mendoj se kanë qenë A. H., A. S. dhe një femër emri i të cilës nuk më kujtohet, por duhet pasur vendim për formimin e komisionit. Gjatë kohës sa kam qenë unë duke punuar në komunë, ky material – inventar asnjëherë nuk është sjellur dhe nuk e kam parë dhe askush te unë nuk ka qenë për të më thënë se dua ta sjelli inventarin. Në dosjen kryesore nuk ka pasur kontratë tjetër shtesë, përveç asaj për furnizim. Unë në fillim nuk kam qenë në dijeni, por në ndërkohë, kam dëgjuar se ekziston edhe një kontratë tjetër, të cilën unë nuk e kam parë. Kam dëgjuar lidhur me kontratën tjetër edhe atë pas ndrrimit të pushtetit lokal. Ndoshta ka qenë nga fundi i pushtetit tim. Sa më kujtohet zyrtari S. S., ka shkuar te kryetari i komunës S. S., ka thënë se mallin i cili duhet porositur, gjendet në depo- magacin të firmës “...”. Administrata e komunës ka qenë e interesuar që ai mall të silltet në komunë. Unë mendoj se ka ekzistuar një kërkesë me shkrim të cilin e ka dërguar kryetari i komunës që të silltet malli, sa më kujtohet firma e ka sjellur një përgjigje, por nuk e di se a e ka sjell me email apo fizikisht por nuk e di se me çfarë përmbatje ka qenë. E gjithë pagesa është bërë ndaj firmës dhe se ekziston procesverbali për praninë – dorëzimin e mallit, ku ekzistojnë edhe anëtarët e komisionit, të cilët e kanë nënshkruar këtë mall, në bazë të letrave malli është pranuar, por në realitet ka munguar malli. Ne kemi pasur nevojë për inventar dhe se kjo ka qenë arsyeja që ne kemi lidhur kontratë për furnizim me inventar me një kompani tjetër, por kuptohet fjala është për objektin e ri të Komunës së Kllkotit, po ta kishim pasur inventarin e porositur sipas kontratës së parë, atëherë të njëjtin e kishim shfrytëzuar për komunë. Inventari ka qenë i dedikuar dhe atë për karriga, tavolina etj.

Komisioni i cili është formuar ka qenë ekskluzivisht për lëndën për të cilën bëhet fjalë. Ka ekzistuar edhe një komision tjetër nga viti 2010 – 2012 të pushtetit të kaluar dhe atë keqpërdorimi i natyrës së përgjithshme. Është e vërtetë se ky komision i ka verifikuar 3-4 lëndë tjera, por jo edhe këtë lëndë, për shkak të vdekjes së zyrtarit të prokurimit M. E., dhe se i gjithë dokumentacioni ka qenë tek ai. Inventari kontestues ka qenë i dedikuar për ndërtesën e komunës, por sigurisht se do të shfrytëzohej edhe për objektin në të cilin aktualisht punonte administrata. Unë personalisht nuk i'u kam drejtuar me shkrim firmës për sjelljen e inventarit, ndërsa kryetari po, të gjitha janë në komunë, sepse unë privatisht nuk e kam bërë kallximin penal. Është e vërtetë se tek unë ka ardhur zyrtari S. S., ndoshta kanë qenë edhe të tjerë, i njëjti ka thënë se do t'a sjell atë mall, por i njëjti asnjëherë nuk ka arritur, megjithatë ne kemi qenë të pregaditur për ta pranuar mallin. Detyra e firmës ka qenë që t'a sjellin inventarin, nëse ne nuk kemi mundur ta vendosim, është dashtë që të shkarkohet në oborr. Me sa e di unë përfaqësuesi i firmës nuk më është drejtuar mua e as Departamentit të Financave, andaj për këtë le ti përgjigjet atij të cilit i është drejtuar, unë kam qenë këshilltar i kryetarit por nuk kam

mundur që t'iu përgjigjem të gjitha pyetjeve. Unë jam përgjigjur në këtë pyetje, ku kam deklaruar se mua përfaqësuesi i ndërmarrjes, nuk më është drejtuar me shkrim, por kryetari të komunës dhe kryetari të komisionit i cili ka shkuar për ta bërë verifikimin e inventarit.

Mua askush nuk më ka treguar se ekziston garancioni bankar për inventar. Unë nuk e di se kush ka dhënë urdher për pagesën e inventarit, por pagesa është bërë në bazë të faturës dhe dokumentacionit tjetër përcjellës. Nuk e di se përfaqësuesi i ndërmarrjes a ka pasur obligim të ruaj apo jo inventarin, por ai ka pasur obligim për me sjell atë në Komunën e Kllokotit. Ka pasur hapsirë për ta sjellur në fsh. Vërbovc në objektin e madh, ku ka qenë stacioni i policisë, dhe ai objekt sot e kësaj dite është i zbrazët, pra ka mundur që të vendoset njëherë aty e pastaj të bartet në objektin e ri të komunës. Unë personalisht nuk i kam bërë kërkesë firmës së “..” për ta sjellur inventarin, mendoj se këtë kërkesë e ka bërë kryetari i komunës dhe drejtori i administratës. Në bazë të kërkesës së kryetarit, E. ka ardhur në zyrën e kryetarit të komunës për t'u marrë vesh lidhur me sjelljen e inventarit. Deri sa kam qenë duke punuar, objekti i komunës nuk ishte i përfunduar. Është e vërtetë se unë kam dëgjuar dikund 2-3 muaj para përfundimit të marrëdhënies së punës lidhur me ekzistimin e një kontrate për ruajtjen e inventarit, me sa më kujtohet diku me 19.12.2017 më është ndërprerë marrëdhënia e punës edhe pse për këtë unë nuk kam marrë vendim. Kallximin penal e ka përpiluar kryetari i komunës S. S. , atëherë nuk kam qenë plotësisht i njoftuar lidhur me atë lëndë, unë e kam pasur atë lëndë në zyre por kontratën për të cilën po bëhet fjalë nuk e kam parë, më vonë kam kuptuar se ekziston ajo kontratë në këtë lëndë, por kjo kontratë nuk ka ekzistuar në dosjen e tenderit, e njejta kontratë është sjellur – përpiluar më vonë. Unë nuk i shmangem asaj se e kam nënshkruar kallximin penal dhe plotësimin e saj. Në një periudhë kohore askush nuk e ka zëvendësuar menagjerin e prokurimit, pastaj ka qenë i caktuar një person me kontratë mbi vepër, emri i tij nuk më kujtohet, i njejti nuk e ka pasur tërë dokumentacionin në disponim sepse ka punuar vetëm 2 muaj, pastaj në atë vend të punës ka punuar P. R., dhe dosja ka qenë aty, ai ku ka punuar dhe me sa e di unë ai e ka gjetur vetëm kontratën kryesore e jo edhe kontratën plotësuese. Kam dëgjuar se ekziston edhe një kontratë tjetër – plotësuese edhe atë nga kryetari i komunës S. S. edhe atë me rastin e komentimit, lidhur me kallximin penal. Nuk ka qenë i obliguar kryetari i komunës që të më njoftoj mua për lidhjen e asaj kontrate. Sipas mendimit tim i obliguar ka qenë drejtori i administratës, apo kryetari i komunës që ta njoftoj përfaqësuesin e firmës për ta sjellur inventarin. Unë nuk e kam bërë zotimin e mjeteve, sepse në atë kohë zotimin e mjeteve për inventar e ka bërë Ministria e Pushtetit Lokal, edhe atë për tenderin e parë në shumën prej rreth 30.000 (tridhjetëmijë) euro. Unë e kam parë këtë zotim të mjeteve. Detyrë e menagjerit të zyrës së prokurimit kanë qenë zbatimi i procedurave dhe në fund të lidh kontratë me kompaninë e cila i plotëson kushtet e tenderit. Mendoj se procedurat janë udhëheqë me rregullat në fuqi. Unë nuk e di arsyen se pse firma përkatësisht përfaqësuesi i saj nuk e ka sjellur inventarin.

Dëshmitari S. T. ka deklaruar: edhe tani jam punëtor i Komunës së Kllokotit, deri në fund të vitit 2016 kam qenë edhe zyrtar i arkivit të komunës. Secili drejtor i cili bjen vendime i dorëzon në arkivin e komunës dhe të njejtat protokolohen edhe atë me numër dhe datë të protokolit. Kam njohuri lidhur me një kontratë të nënshkruar nga ana e komunës dhe firmës “..” nga fsh. Pozhoran, unë nuk e di përmbajtjen e asaj kontrate, pasi që e njejta ka qenë edhe në gjuhën shqipe, por mendoj se ajo ka qenë e nënshkruar nga shefi i zyrës së prokurimit M. E., tani i ndjerë, dhe firmës “..” nga fsh. Pozhoran. Kontratë e dt.10.12.2012 nuk më kujtohet, sepse nuk ka numër të protokolit dhe se kjo është e nënshkruar nga S.M. dhe firma “..”, ndërsa kontratën tjetër të cilën e kam protokoluar unë ka qenë e nënshkruar nga ana e shefit M. E. dhe firmës “.... Nuk mundet asnjë kontratë pa numër dhe datë të protokolit të futet në arkivin e Komunës. Unë si zyrtar i arkivit kam punuar nga muaji mars 2012 e deri në muajin dhjetor 2016. Para meje në këtë pozitë ka punuar N. S.. Në rastet kur unë kam shkuar në pushim vjetor

në bazë të autorizimit të drejtorit të administratës më ka zëvendësuar dhe atë T. N. dhe D. V.. Të gjitha dokumentacionet që gjenden në arkivë më kujtohen shumë mirë. Kryetari i komunës S. S., ma ka ndërruar vendin e punës pa kurrfarë arsytimi nga zyrtari i arkivit në zyrtar të projekteve. Mendoj që ish- kryetari më ka ndërruar nga vendi i punës së arkivistit me arsytim se rrjedhin informatat nga dokumentat zyrtare. Është e vërtetë se drejtori i firmës “...” ka parashtruar kërkesë me shkrim i cili ka kaluar përmes protokolit të arkivit , përmbajtja e tekstit ka qenë e shkruar në gjuhën shqipe , por mendoj se ka pasur të bëjë lidhur me sjelljen e inventarit, përmbajtjen e të njejtit tekst nuk e kam ditur, megjithatë deklaroj se kërkesën e protokoluuar me numer 6615, unë qëndroj prapa saj. Kontratat e juaja e as e imja nuk kanë numra të protokolit, arsyen nuk e di. Kontrata e dt. 10.12.2012 është nënshkruar nga kryetari i komunës dhe operatori ekonomik “..” dhe në kontratë në pikën 6 shkruan se një kopje i shkon Komunës së Klllokotit, një kopje ndërmarrjes dhe zyrës së prokurimit, duke mos e ditur se kush është dashur që ta sjell kontratën në arkivë për ta protokoluuar. Kontrata për ruajtjen e inventarit është lidhur në mes të ndërmarrjes “..” dhe kryetarit të Komunës së Klllokotit edhe atë zyrën e furnizimit, i ndjeri M. E. dhe për protokolim është dashur ta dorëzoi M. E..

Dëshmitari P. R. ka deklaruar: unë jam i punësuar në Komunën e Klllokotit prej datës 01.06.2015, kam filluar punën si menaxher i prokurimit. Unë nuk jam i informuar sa i përket kontratës lidhur me furnizim për inventar, e lidhur ndërmjet Komunës së Klllokotit dhe ndërmarrjes “ ...”. Unë me prezencën e komisionit e kemi marrë lëndën dhe e kemi verifikuar dhe se kontrata e datës 10.12.2012, e cila më është kërkuar nuk e kemi gjetur sepse unë kam ardhur në këtë vend të punës diku 8 muaj pas vdekjes së menaxherit M. E., dhe se ato lëndë kanë qenë pa mbikqyrje dhe ndoshta kanë mundur me qenë të prekura, këto lëndë janë bartur prej zyrës në zyre sepse një kohë kemi qenë me qira e pastaj kemi dalë në objektin e komunës, i cili paraprakisht është ndërtuar për mirëqenie sociale, mirëpo i njejtë gjithëherë është shfrytëzuar nga komuna. Unë këtë kontratë për të cilën po bëhet fjalë nuk e kam pasur në lëndë dhe sa e di unë ajo kontratë është prezantuar në komisionin disiplinor. Çdo kontratë duhet me u protokoluuar në arkivin e komunës, megjithatë nuk e di saktë se a duhet të mbetet një kopje e kontratës në arkiv të komunës, kështu që nuk mund të përgjigjem për punë të cilat nuk i përkasin zyrës sime. Gjatë kohës sa kam udhëhequr detyrën e prokurimit nuk jam marrë me procedura të tenderimit për shkak se nuk kam qenë i çertifikuar nga ana e Ministrisë së Financave. Kontratat nënshkruhen nga ana e menaxherit të zyrës së prokurimit si dhe operatorit ekonomik i cili e fiton tenderin. Nga data 05.10.2014, kur ka vdekur menaxheri i zyrës së prokurimit e deri në momentin kur unë kam filluar të punoj më datë 01.06.2015, kjo zyrë nuk ka pasur menaxher e as zyrtar tjerë të prokurimit, kështu që nuk e di se kush ka qenë përgjegjës, për kryerjen e punëve të prokurimit për Komunën e Klllokotit, e poashtu nuk e di se kush ka mundur të ketë qasje në atë zyrë. Unë e njoh N. N. i cili ka qenë Drejtor i Financave e njoh edhe të akuzuarin S.M., ish-kryetarin. Sa i përket kontratës së datës 10.12.2012, lidhur me ruajtjen e inventarit , unë nuk mund ta di se kush ka mundur ta heq nga dosja, pasi që edhe ka pasur mundësi sepse lëndët janë bartur nga vendi në vend tjetër. Me rastin e pranimit të detyrës së menaxherit të zyrës së prokurimit nuk është formuar komision për pranimin e detyrës, e poashtu nuk e di se kur ka munguar menaxheri i zyrës së prokurimit, kush ka mundur t’I nënshkruaj kontratat. Kontratën e datës 10.12.2018 nuk e kam pasur në dorë, por prej meje është kërkuar vetëm verifikimi i kësaj kontrate në dosje. Sa i përket inventarit të kontraktuar sipas kontratës së parë në mes komunës dhe ndërmarrjes “...”, jo zyrtarisht jam informuar se inventari gjendet në komunë-objektin e ri e jo në zyrën time. Sipas mendimit tim, ky inventar nuk ka mundur të sillet në komunë për shkak të mungesës së hapsirës, sepse inventari është blerë për objektin e ri të komunës.

Dëshmitari A. S., ka deklaruar: nga viti 2015 unë punoj në Komunën e Kllokotit, është e vërtetë se unë lidhur me pranim dorëzimin e inventarit të Komunës së Kllokotit, kemi marrë veprime të caktuara kam qenë edhe anëtar i komisionit për të cilën bëhet fjalë, data nuk më kujtohet dhe nuk mund ta di saktësisht. Unë në atë komision kam qenë së bashku me D. R. dhe A. H., këtë komision e ka formuar kryetari i Komunës së Kllokotit, S. S.. Detyra e komisionit ka qenë që të shkojmë dhe ta shohim inventarin në kompaninë e cila ka fituar tenderin, dhe kompania quhej “...” në fshatin ..., Komuna e Vitisë. Ne si komision kemi shkuar dhe e kemi vizituar kompaninë në fjalë, përkatësisht për ta shikuar inventarin dhe me këtë rast kemi hartuar raport me shkrim. Ne kemi konstatuar se në depon e kompanisë në fjalë në fshatin ... nuk ka pas mall, ndërsa pronari i kompanisë “..”, E. neve na ka thënë se inventari gjindet nëpër depot në tërë Kosovën dhe posa të kërkohet, unë mund ta siguroj. Unë si kryetar i komisionit nuk kam dashtë që ti vizitoj depot e tilla nëpër Kosovë.

Eksperti I. T. ka deklaruar: unë qëndroj pranë ekspertizës financiare të hartuar me dt.04.07.2019, dhe më dt.16.01.2019, konsideroj se hartimin e ekspertizave e kam mbështetur në aktvendimet e dhëna nga Gjykata Themelore në Gjilan. Në ekspertizën e parë dëmin e shkaktuar nga kontrata e lidhur në mes palëve, përkatësisht Komuna e Kllokotit dhe pronarit të ndërmarrjes tregtare private “..” në .., e kam llogaritur duke u bazuar në ligjin nr.03/L-162 për tatimin në të ardhura të korporatave, përkatësisht në zhvlerësimin e mjeteve të cilat kanë qëndruar tek pronari i biznesit për një kohë prej 5 viteve. Dëmi është zhvlerësuar duke u bazuar në nenin 15 të ligjit të cekur më lartë, tek kategoria e zhvlerësimit, ku bëjnë pjesë mbyllet dhe paisjet e zyrës. Në këtë ligj, me kategorinë 2, përqindja e amortizimit është 20%, andaj në qoftëse i marrim për bazë, vitet e kaluara dhe shumën me kontratë prej 29.330 euro, amortizimi për 5 vite, mjetet sipas kontratës, mbyllet dhe paisjet për zyre, pas viteve, do ta kishin vlerën 0. Andaj, dëmi i shkaktuar do të ishte i barabartë me vlerën e mjeteve me kontratë, por gjatë fazës së ekspertimit nuk është mundur të konstatohet, koha e prodhimit të këtyre paisjeve, prandaj amortizimi i llogaritur, nuk paraqet vlerën e saktë. Çka do të thotë se paisjet përkatësisht mbyllet dhe paisjet për zyrë, janë kontraktuar me datën 05.12.2012, ndërsa sipas procesverbalit mbi dorëzimin e inventarit të datës 19.04.2018, këto paisje nuk e definojnë kohën e prodhimit të tyre. Ky ishte versioni i parë i llogaritjes së dëmit të shkaktuar, ndërsa me ekspertizën plotësuese, me kërkesën e gjykatës, më është kërkuar që dëmin e shkaktuar ta llogarisë në bazë të mjeteve të deponuara në bankë nga qytetarët, pa ndonjë destinim të caktuar mbi një vit, andaj llogaritja e bërë ka sjellur deri te shuma e dëmit të shkaktuar, duke llogaritur kamatën vjetore, sipas vendimeve të BQK-së përkatësisht buletini mujor statistikor, shtator 2018, dhe ka rezultuar se dëmi i shkaktuar kap shumën prej 2,748.37 euro.

Nuk më kujtohet se kam vërejt në aneks kontratë, përmes secilës është paraparë që inventari të silllet në Komunën e Kllokotit, pas përfundimit të objektit punues e ndoshta është mirë të shikohet se kur ka qenë përfundimi i punimeve të objektit të komunës, dhe me siguri nuk ka qenë pas 5 viteve. Unë nuk ju kam referuar aneks kontratës, por e kam marrë kontratën bazë të lidhur në mes të komunës dhe operatorit ekonomik “..” nga ... Sa i përket aneks kontratës të dt.10.12.2012, unë nuk mund ta di se ju kam referuar kontratës së këtillë. Po, jam në dijeni se një pjesë e inventarit i është dorëzuar Komunës së Kllokotit pas ekspertizës, edhe atë diku në fazën e hartimit të ekspertizës plotësuese, për këtë arsye e kam vizituar objektin e komunës dhe jam bindur në vendin e ngjarjes, siq shihet edhe nga dëshmitë përmes fotove të bëra. Megjithatë unë nuk kam qenë i obliguar me urdhëresën e gjykatës të konstatoj se a është dërguar inventari, gjegjësisht paisjet sipas kontratës bazë. Unë kam qenë në objektin e komunës bashkë me kryetarin, tani të akuzuarin S. M., ish kryetarin, dhe nga i njejti jam informuar për paisjet dhe pjesën tjetër të inventarit, dhe se një pjesë e inventarit ka qenë e montuar drejtëpërdrejtë në zyret e Kuvendit Komunal, ndërsa pjesa tjetër, ka qenë e vendosur nëpër zyre, si tavolinat e punës, karriket, ormanat e punës, edhe atë inventari ka qenë i sjellur

në objektin e ri të komunës. Deri në kohën e hartimit të ekspertizës, besoj se nuk është bërë pranimi i objektit të ri të komunës, por megjithatë unë nuk mund ta dij saktë. Llogaritja është bërë për faktin se nuk është përmbushur kontrata për dërgimin e pajisjeve dhe inventarit, ndërsa data e llogaritur deri me dt.19.04.2018, ka të bëjë me periudhën e arritjes së një pjese të inventarit dhe paisjeve. Kërkesën e dt.30.11.2015, nga pronari i NTP “...” nga .., e kam prezentuar në ekspertizë, për të konfirmuar gadishmërinë e pronarit për dërgimin e inventarit dhe paisjeve, por mosllogaritjen e dëmit e kam mbështetur në faktin se paisjet dhe inventari, nuk janë dorëzuar as në vitin 2018, kur komuna ka pasur gadishmëri të plotë për pranimin e paisjeve të kontraktuara, ndërsa vlera e mjeteve të padorëzuara ka qenë 4,750 euro, dhe se vlera e kamatës, llogaritet për periudhën deri në ekspertizën plotësuese, përkatësisht me dt.15.01.2019, arrin shumën prej 42.47 euro. Dëmi i shkaktuar Komunës së Klllokotit, i llogaritur në ekspertizë në shumën prej 2,970.34 euro, është llogaritur duke përfshirë periudhën kohore prej nënshkrimit të kontratës e deri në datën e dorëzimit të paisjeve dhe inventarit, përkatësisht prej dt.18.04.2018, ndërsa dëmi i shkaktuar në pjesën e mbetur të inventarit dhe paisjeve në shumën bazë prej 4,750.00 euro, është llogaritur vetëm për periudhën prej dorëzimit të pjesës së parë të paisjeve dhe inventarit, dhe deri në datën e hartimit dhe përkatësisht datën 15.01.2019.

Dëmi është konstatuar në bazë të mbajtjes së mjeteve në shumën prej 29,330 euro, në një periudhë kohore mbi 5 vite nga ana e operatorit ekonomik “..” nga .., mjetet të cilat i ka dhënë Komuna e Klllokotit, kjo nënkupton llogaritjen e kamatës për mbajtjen e mjeteve avans mbi 5 vite, nga ana e operatorit ekonomik. Zyrtarët e komunës kanë qenë të obliguar me respektu kontratën, ashtu siq është nënshkruar, pikërisht lëshimi i parë qëndron në faktin se mosgadishmëria e komunës, për ta pranuar inventarin dhe në asnjë dokument nuk kam hasur që komuna ka kërkuar të silltet inventari i kërkuar, kjo qëndron për faktin se, nga komuna është hartuar procesverbali mbi pranimin e inventarit dhe paisjeve të pa arritura, këtu kemi të bëjmë me shkelje esenciale të kontratës. Siç e kam cekur edhe më herët, në asnjë moment nuk kam vërejtur se zyrtarët e Komunës së Klllokotit, kanë kërkuar pranimin e inventarit, dhe gjithënjë ka qenë intencë e shtyerjes së pranimin të këtij inventari, me arsyetimin e mos kryerjes së punëve në objektin e ri të komunës, prandaj nuk besoj që në rrethana të tilla është vërtetuar se në lokalet e operatorit ekonomik, të kenë ekzistuar paisjet dhe inventari i kontraktuar, dhe a është i gatshëm për të arritur. Nuk kam pasur njohuri në asnjë periudhë kohore që ka qenë inventari apo paisjet të vendosura në depo për tu dorëzuar sipas kontratës.

3.Mbrotja e të akuzuarëve

I akuzuari S. M. ka deklaruar: në vitin 2010, është formuar Komuna e Klllokotit, nga Unioni Evropian, kemi pranuar një shumë të mjeteve të caktuara (donacion), për ndërtimin e objektit të ri të komunës. Firma e cila ka fituar tenderin për ndërtimin e objektit të ri të Komunës së Klllokotit, ka ardhur deri te ngadalësimi i punimeve, përkatësisht ndërprerja e tërësishme e punimeve të objektit, për shkak të mosmarrëveshjes së Unionit Evropian dhe kompanisë nga Kroacia e cila ka fituar tenderin në fjalë. Për këto mosmarrëveshje, rasti ka shkuar në gjykatë, deri në zgjidhje të këtyre mosmarrëveshjeve, në të njëjtën kohë, ne si komunë kemi marrë një sasi të mjeteve nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në vlerë prej 30 (mijë) euro. Në ndërkohë është paraqitur problemi i mos ndërtimit të objektit të Komunës së Klllokotit, afati i përfundimit të punimeve te komunës ka qenë 12 korrik 2012, ndërsa deri në këtë kohë, ishin kryer vetëm punimet e vrazhda. Unë si kryetar i komunës kam konsideruar se objekti i komunës do të ndërtohet brenda gjashtë muajve të paraparë me kontratë, megjithatë edhe sot e kësaj dite ky objekt nuk është i përfunduar në tërësi. Kur është fjala për inventarin, në fund të vitit 2011, përkatësisht në muajin dhjetor, ne si komunë e

kemi buxhetin e vogël, dhe kemi konsideruar se çdo donacion për komunën tonë është i mirëseardhur e që në këtë rast ne si komunë i kemi pas dy mundësi, edhe atë, ose t'i humbim mjetet, të cilat na i kishte ndarë ministria përkatëse, apo ta kem inventarin ashtu siç e kemi sot. Atëherë ne jemi takuar të gjithë në zyrën time, e që në atë kohë ishte, tani i ndjeri, M.E.shëf i prokurimit, dhe kemi biseduar për mënyrën se si të mos i humbim, këto mjete të cilat na i kishte dhënë ministria. Propozimi i shëfit të prokurimit të atëhershëm ka qenë, inventarin të cilin do të pranojmë nga ana e firmës, e cila e ka fituar tenderin, t'ia bëjmë pagesën edhe atë në bazë të një kontrate, duke e obliguar kompaninë në fjalë, ashtu që në momentin kur t'i pranojmë çelësat e ri të Komunës, brenda 15 ditëve t'a njoftojmë firmën që të na sjellin inventarin. E gjithë kjo është bërë me qëllim të mos na humbin mjetet dhe të shkojnë në suficit, ne edhe sot nuk jemi të vendosur në objektin e ri të Komunës. Momentalisht inventari i cili ekziston në objekt dhe është i vendosur në hapsirën e këtij objekti, ngase kushtet janë të mira për ruajtjen e tij, në kohën kur është lidhur kontrata në mes të komunës dhe kompanisë për furnizim me inventar, shëfi i prokurimit ka qenë M. E., dhe se i njejtë e ka nënshkruar kontratën në pajtim me ligjin në fuqi. Pas nënshkrimit të kontratës ne nuk kemi pasur hapsirë për vendosjen e inventarit të porositur, çka do të thotë se në atë kohë nuk kemi pasur hapsirë të mjaftueshme për personelin.

Unë në asnjë moment nuk kam pasur qëllim që të kem ndonjë përfitim personal për vete apo për kompaninë “.”, nga ..., megjithatë konsideroj se në atë kohë kompania në fjalë na ka dal haku, kështu që qëllimi as i imi e as i anëtarëve të komisionit, nuk ka qenë që t'i shkaktoj dëm komunës e as dikujt tjetër, e me këtë përvojë që e kam tani nuk do ta bëja. Në fund mendoj se askush nuk ka pasur përfitime dhe ka qenë qëllimi i mirë i komunës, si dhe për operatorin që e ka fituar këtë. Në momentin kur e kemi bërë pranim-dorëzimin e detyrës me S. S., e të njëjtit i kam thënë, ekziston lënda si dhe obligimi për firmën “...”, që kur të përfundojë ndërtimi i objektit të komunës, inventari do të vendoset në objektin e ri të komunës. Inventari i porositur sipas kontratës, tani ka arritur në objektin e ri të komunës, edhe atë në tërësi. Pjesa e fundit e inventarit mendoj se është sjellur para 10 ditëve, e që bëhet fjalë për një sasi të vogël të inventarit. Kështu që unë nuk e ndjej veten fajtor për veprën penale e cila më vihet në barrë. Unë për disa herë jam në gjykatë, dhe se të gjitha këto procedura janë inicuar nga ... dhe N.N., andaj kam informacione nga zyrtarët edhe atë, si psh, K. R., shëf i financave, i cili më ka thënë se të gjithë dokumentacionin tënd ma kanë marrë, S. S. dhe N. N., të cilët kanë mundur ta shkyejnë, këtë e kanë bërë për qëllime politike, dhe te njejtën ia kanë kthyer shëfit financiar, nga N. N. edhe atë pas përfundimit të mandatit. Sikur të ishte kjo kontratë e protokoluar, sigurisht se nuk do të mungonte nga dosja, për inventarin në fjalë, mjetet financiare janë ndarë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, por nuk e di se a ka qenë grant, apo diçka tjetër, është e vërtetë se unë e kam formuar komisionin për pranimin e inventarit. Siç deklarova edhe më herët se jemi takuar bashkarisht me qëllim që të gjejmë modusin për pranimin e inventarit e mjetet mos të shkojnë në suficit, në këtë takim kemi qenë unë, M. E., shëf i zyrës së prokurimit si dhe anëtarët e komisionit: S. S., N. . dhe Z. S., nuk kemi pas arsye që të ndikojmë në komision për pranim të inventarit, ne në emër të komunës kemi mundur të bëjmë kërkesë dhe ofertë të re për vitin tjetër kalendarik, që të na ndajnë mjete të njejtë (grant), por kjo ka qenë një pikëpyetje se a mund t'i realizojmë këto mjete apo jo. Ekzistojnë pesë zyrtar në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, që në bazë të komisionit për pranim të inventarit, kanë rregulluar dokumentacionin në bazë të të cilave ministria përkatëse ka bërë pagesën. Në rastin konkret nuk më kujtohet se a kam nënshkruar diçka përpos aneks kontratën siç e thashë më herët. Unë kam pas njohuri se nga anëtarët e komisionit është nënshkruar procesverbali për pranim të inventarit, edhe pse i njejtë nuk ka arritur, por deklarova edhe më lartë, që ne jemi dakorduar për një gjë të tillë. E kam ditur para se të formohet komisioni, e po ashtu pas hartimit të procesverbalit mbi pranimin e inventarit, se i njejtë nuk kishte arritur në objektin e ri të Komunës së Klllokotit, sepse jam mbështetur në atë, se me aneks kontratë e kemi obliguar

operatorin ekonomik, që pas përfundimit të punëve në objektin e komunës, t'a sjell inventarin. Unë nuk kam qenë i involvuar në procedurat e tenderimit për inventarin e objektit të ri të Komunës së Klllokotit, e kam ditur që së pari duhet të pranohet inventari, e pastaj të bëhet pagesa, unë kam lejuar që të bëhet pagesa, nga fakti se në ndërkohë kemi formuar aneks kontratën dhe në këtë mënyrë e kemi lejuar pagesën. Antarët e komisionit e kanë ditur se inventari nuk ka arritur në komunë, komisioni nuk ka reaguar sa i përket hartimit të procesverbalit për pranimin e inventarit, e i cili në realitet nuk ka arritur në objektin e komunës, por komisioni e ka marrë për bazë garancionin bankar si dhe aneks kontratën, mosarritja e inventarit në objektin e komunës, ka qenë për shkak të mos përfundimit të punëve.

I akuzuari Z. S. ka deklaruar: që nga viti 2009, unë kam punuar si Zyrtar i Shërbimeve Sociale, pranë QPS-së në Klllokot. Unë kam qenë anëtar i komisionit për pranim të inventarit për objekt të komunës. Kryetari i Komunës S. M. na ka ftuar në zyrën e tij, mua, N. dhe S., në momentin kur kam shkuar unë në zyrën e kryetarit, ai ka qenë vetëm në zyre, dhe ka filluar të më shpjegoj se cila është arsyeja që na ka ftuar, edhe atë duke shpjeguar se bëhet fjalë për inventarin për ndërtesën e objektit të komunës së re, duke na treguar lidhur me një grant nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal, për sigurimin e inventarit të objektit të ri të komunës, duke thënë se është siguruar shuma e nevojshme e mjeteve për inventarin e komunës. Kryetari ka kërkuar që me qëllim të mbrojtjes së atyre mjeteve dhe sigurimit të inventarit, na me i dhënë nënshkrimet tona në një raport që ka qenë në tavolinën e kryetarit. Unë besoj se raportin e pranimit të inventarit e kishte hartuar menaxheri i zyrës së prokurimit, Mustafë Emini, tani i ndjerë e këtë më mirë e din kryetari S. M.. Fillimisht, unë kryetarit i kam thënë se mos po hyjmë në një problem, gjegjësisht mos po na del ndonjë problem, pasi që inventari mungon, pas dyshimeve të cilat unë i kam shprehur në zyrën e kryetarit, ka kërkuar prej meje dhe më ka siguruar se aty ka qenë raporti dhe dosja e tenderit, dhe atë duke më thënë se komuna, i ka siguruar të gjitha dokumentet e nevojshme të parapara me ligjet në fuqi dhe për sigurimin e inventarit dhe mos humbjen e mjeteve. Në ndërkohë kryetari i ka ftuar edhe menagjerin e prokurimit, M. E., i cili ka hyrë në zyre me një letër në dorë, duke treguar në mënyrë vertikale, duke më thënë Z. në qafë timen, nënshkruaje raportin se ja ku e kam raportin bankar të operatorit ekonomik NTP“.”, nga ... përndryshe mjetet na shkojnë dhe ne mbesim pa inventar për objektin e ri të komunës. Ne paraprakisht nuk kemi pasur asnjë njohuri, se si kanë shkuar punët rreth prokurimit, e as ndaj kompanisë që e ka fituar tenderin. Qëllimi i anëtarëve të komisionit nuk ka qenë përfitimi, unë nuk i njoh mirë procedurat e financave, por sa kam informacione, është vendim i kryetarit, dhe Drejtorisë për Financa, të cilët e bëjnë ekzekutimin e pagesave. Mjetet kanë qenë të ndara nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal për komunën tonë dhe pesë komuna tjera, edhe atë sipas njoftimit të kryetarit që na ka shpjeguar. Për këtë rast kam dhënë deklaratë në polici dhe prokurori dhe mbetem në tërësi pranë të njejtave. Unë te operatori ekonomik- kompania NTP,“.” në ..n, kam shkuar atëherë pasi që është iniciuar procedurë disiplinore. Me sa e di, nga puna jam larguar në nëntor të vitit 2015, atëherë edhe kur ka ardhur kryetari S. S.. Unë i kam dëgjuar zyrtarët e komunës, duke thënë se firma NTP “..” nga .., ka bankrotuar dhe inventari ka mbetë atje, pastaj e kam pyetur zyrtarin kryesor financiar, K.R. se ku e ka blë komuna inventarin, K.ma ka treguar emrin e firmës, më ka thënë se tenderin e ka fitu firma “..”..., e cila gjindet në Pozhoran, nga pronari E. A.. Unë jam nisur për të shkuar te E. A., para përfundimit të orarit, diku rreth orës 16:00 kam arritur te ai, meqë e gjeta firmën, shkova te E. dhe e kam pyetur se a ki letra- dosje të tenderit për inventarin e Komunës së Klllokotit, dhe i kam thënë se pse E..nuk është inventari në komunë, ai na tha se kemi marrëveshje edhe atë duke më thënë se pasi që të ma bëjnë kërkesën komuna, unë brenda 10 ditëve e sjell inventarin. Atij i tregova se komuna ka iniciuar procedurë disiplinore, për nënshkrimin e raportit lidhur me pranimin e inventarit, edhe pse i njejt nuk e kishte pranuar. El.më tha, Z., firma ime nuk ka bankrotuar dhe kemi marrëveshje me sjell inventarin kur të

jetë e gatshme komuna, unë e pyeta se a e keni atë marrëveshje, i njejtë më tha se po, E.. ka shkuar dhe komplet e ka sjellur dosjen, marrëveshjen, të cilën e ka fotokopjuar dhe ma ka dhënë një kopje, unë e kam pranuar marrëveshjen prej E., ngase më është dashur të dal para komisionit disiplinor. Paraprakisht nuk kam dëgjuar se ekziston ndonjë kontratë apo marrëveshje për këtë çështje, marrëveshja nuk ka pas vulë të protokolimit, ndërkohë jam njoftuar se marrëveshja në fjalë, mungon në dosjen e tenderit, me pas ditë këtë punë që shkon 7 vjet, e inventari mbetet pa u sjell, nuk do të kishte pas kush të më obligoj t'a nënshkruaj. Në fund deklaroj se për nënshkrimin e dhënë në raport për pranimin e inventarit, nuk do ta kisha bërë, por më ka bindur menaxheri i zyrës së prokurimit, kryetari po ashtu na ka thënë se brenda 3(tre) muajve edhe atë sipas planit dinamik, do të arrijë inventari i komunës. Unë e kam parë këtë kontratë dhe e njëjta e ka edhe vulën e zyrës së kryetarit të komunës, me nënshkrimin e tij, sa kam njohuri, kryetari i komunës S. M. është larguar nga komuna në muajin janar 2014, pas zgjedhjeve, unë e njoh N. N., i njejtë e di se ka ushtruar kallzim penal ndaj meje dhe anëtarëve të komisionit, ai në atë kohë ka qenë drejtor i financave, ndërsa kryetar i komunës ka qenë S.S., me N. N. nuk kam pas problem, ndërsa me kryetarin e komunës S. S., kam pas probleme të shumta, të gjitha këto janë bërë me ndikim të kryetarit, dhe raportet në mes S. M. dhe S. S., kanë qenë tmerrësisht të këqija. Në zyrën e kryetarit unë kam shkuar i pari dhe i pari e kam dhënë nënshkrimin tim, ndërsa anëtarët tjerë S. S. dhe N. P. nuk kanë qenë prezentë. Unë paraprakisht nuk kam pasur njohuri se pse jam ftuar në zyrën e kryetarit, qëllimi i nënshkrimit të raportit, ka qenë m'u siguru inventari për objektin e komunës. Në rastin konkret përkatësisht me rastin e nënshkrimit të raportit për pranimin e inventarit që po bëhet fjalë, kryetari i komunës S. M. nuk na ka bërë presion, por vetëm na ka bërë lutje me qëllim të mos humbin mjetet financiare për objektin e ri të komunës, në kohën kur jam caktuar anëtar i komisionit për pranimin e inventarit, unë kam qenë punëtor në kuadër të Komunës së Klllokotit, raportin ma ka ofruar kryetari i komunës S. M., i cili ka qenë mbi dosjen e tenderit dhe vetëm me dhënë nënshkrimin, por jam penduar shumë, për shkak të jo profesionalizmit të tij që e ka hartuar. Ky raport të cilin e kam nënshkruar në zyrën e kryetarit të komunës, ka qenë i shkruar në gjuhën serbe, kryetar i komisionit kam qenë unë, e pikërisht atë raport është dashur ta bëj unë dhe është fatkeqësi që nuk e kam bërë unë, gjuhen serbe e njoh mirë edhe në të shkruar dhe në komunikim, raportin në fjalë nuk e kam lexuar, me pas lexuar, të njëjtën nuk e kisha nënshkruar fare. E kam ditë përmbajtjen e raportit, edhe atë pasi që jam njoftuar nga ana e kryetarit të komunës, e që i kam besuar plotësisht kryetarit dhe menaxherit M.E.. Ne nuk kemi dalë në teren për të verifikuar se a ekziston inventari apo jo, nuk e kam ditur vlerën e garancionit bankar se sa ka qenë i deponuar në bankë nga operatori ekonomik, po ashtu nuk e kam pyet se sa është vlera e garancionit bankar, sepse i kam besuar M. E..

I akuzuari S. S. ka deklaruar: Unë kam filluar të punoj në Komunën e Klllokotit, me 23 dhjetor 2010, ku në ndërkohë përkatësisht muajin nëntor 2015, jam larguar nga puna pikërisht për shkak të këtij rasti, unë kam punuar në pozitën e inspektorit sanitar. Nuk e di saktësisht datën, por jam njoftuar në zyrën e kryetarit të komunës S.M., se jam anëtar i komisionit. Në momentin kur kryetari i komunës S. M. më ka ftuar në zyrën e tij, më ka njoftuar se bëhet fjalë për mjetet e ndara nga ministria përkatëse për inventarin e objektit të ri të komunës, diku në një vlerë prej 29 (njëzet e nëntë mijë) euro, dhe se duhet ta nënshkruajnë raportin i cili ka pasur të bëjë me pranimin e inventarit, me qëllim të pagesës për inventarin në fjalë, paraprakisht unë raportin nuk e kam lexuar, nuk e kam ditur se për çfarë bëhet fjalë, por vetëm e kam nënshkruar. Në fillim unë nuk i kam ditur pasojat e nënshkrimit të raportit për pranimin e mallit, sepse kam besuar se është fjala për një veprim të mirë në dobi të komunës dhe se i kam besuar kryetarit të komunës. Qëllimi i i nënshkrimit të këtij raporti nga ana ime ka qenë që të pranojmë inventarin i cili është në interes të të gjithë neve-komunës. Pas nënshkrimit të raportit në fjalë e kam parë aneks kontratën, kur ka filluar procedura disiplinore ndaj meje, për këtë

nënshkrim nuk kam pasur kurrfarë përfitimi personal. Deri me këtë rast unë nuk kam pasur përvojë në këtë drejtim të kësaj natyre, dhe se nuk e di se ky raport nga kush është hartuar para se ta nënshkruaj atë. Kryetari i komunës S.M. nuk ka bërë presion direkt me rastin e nënshkrimit të raportit për pranim të mallit. Unë nuk e kam nënshkruar me vullnetin tim raportin, por kryetari i komunës ka thënë se duhet patjetër me nënshkru raportin për pranim të inventarit, me qëllim që paret mos të na kthehen prapa, kryetari i komunës na ka sqaruar paraprakisht rastin në tërësi e pastaj në fund na ka thënë se duhet patjetër me nënshkruar këtë raport, për mos me shku paratë në suficit dhe për këtë ne i kemi besuar kryetarit të komunës.

E akuzuara N. P. ka deklaruar: është e vërtetë se unë në polici dhe prokurori kam dhënë deklaratë për këtë çështje dhe mbesë pranë të njëjtave. Për herë të parë kam filluar të punoj në Komunën e Kllkotit në muajin nëntor të vitit 2011, edhe atë kam punuar si zyrtare për mbrojtjen dhe kontrollin e tokës bujqësore dhe njëkohësisht si këshilltare bujqësore e caktuar nga Ministria e Bujqësisë nga Komuna e Kllkotit. Ka qenë muaji dhjetor i vitit 2012, kryetari S. M. na ka ftuar në zyrën e tij, dhe në momentin kur kam shkuar në zyre, aty kanë qenë prezentë Z. S. dhe S. S., e që në ndërkohë ka hyrë në zyre, zyrtari i prokurimit M. E., tani i ndjerë. Kryetari i komunës S. M., në atë rast na ka njoftuar se Ministria e Pushtetit Lokal e ka ndarë një shumë të mjeteve për inventarin e ri të objektit, pastaj na njoftoj se meqë objekti i ri i komunës nuk është ende gati, e që bisedohej se brenda 2-3 muajve duhet të përfundoj objekti i ri i komunës. Pastaj ka filluar që të na njoftoj që po që se mjetet në fjalë nuk i shfrytëzojmë deri në fund të vitit 2012, atëherë këto mjete do të shkojnë në suficit. Pastaj na ka njoftuar se meqë komuna e jonë ka një buxhet të vogël dhe nuk ka mundësi që pastaj me buxhetin e komunës tonë, të sigurojmë inventarin për objektin e ri, duke na thënë neve se duhet me nënshkru raportin për pranimin e inventarit, duke thënë se ne e kemi edhe garancionin bankar edhe kontratën që inventari do të ruhet në depo, derisa të ndërtohet-kryhet objekti i ri, nga kompania e cila e ka fituar tenderin dhe në momentin kur të përfundojnë punët ndërtimore të objektit, atëherë operatori ekonomik do ta sjell inventarin, dhe unë kam qenë e bindur se nuk po bëj diqka në dëm të komunës, por po e nënshkruaj raportin për me siguru inventarin për të mirën e Komunës së Kllkotit. Unë me rastin e nënshkrimit të këtij raporti asnjëherë nuk kam menduar se po e nënshkruaj të njëjtin raport me qëllim të përfitimit për vete apo dikujt tjetër, për me fitu për këtë rast apo me humb dikush për këtë inventar, kurrë nuk e kam menduar se mund të përfitoj dikush nga ky inventar, e po të kisha menduar, asnjëherë nuk do ta kisha nënshkruar të njëjtën. Unë më parë nuk e kam ditur se jam caktuar si anëtare e komisionit, kështu që për herë të parë jam njoftuar atëher kur kam shkuar në zyrën e kryetarit S. M. Unë nuk e di se kush e ka nënshkruar raportin lidhur me pranimin e inventarit, por mendoj se atë e ka shkruar, dikush nga zyra e prokurimit. Me sa më kujtohet, raporti ka qenë i hartuar në gjuhën serbe, të njëjtin nuk e kam lexuar se edhe ashtu nuk e njohë mirë gjuhën serbe. Përpos kryetarit të komunës S. M., në këtë rast ka qenë i involvuar edhe menagjeri i zyrës së prokurimit, M. E., tani i ndjerë dhe në momentin kur kryetari i komisionit Z. S., i tha kryetarit të komunës, se si mund t'a nënshkruajmë raportin, kur inventari nuk është në komunë, atëherë M. E., i ka patur në duar, garancionin bankar, duke na treguar me dorë se gjithqka është në rregull dhe duke na thënë se lirisht mund ta nënshkruani pranimin e inventarit, sepse brenda 2-3 muajve, inventari do të arrij, pas nënshkrimit të këtij raporti R. H., e kam njoftuar se nuk e di se a është në rregull a jo, duke na thënë se inventari do të vij pas 2-3 muajve. Kryetari i komunës pas njoftimit lidhur me arsyen e nënshkrimit të këtij raporti, na ka lutur, por edhe duke na thënë se duhet me nënshkru raportin me qëllim që në ndërkohë të na sigurojnë inventarin.

I akuzuari E. A. ka deklaruar: Sa i përket tenderit të komunës lidhur me inventarin për objektin e ri të komunës, unë kam aplikuar sipas tenderit të shpallur nga ana e Komunës së

Kllokotit, në atë tender kanë marrë pjesë edhe firma të tjera, por unë kam qenë fitues tenderi. Edhe pse tenderi ka qenë i shpallur me vonesë, çka do të thotë në fund të vitit kalendarik. Megjithatë unë në atë tender jam shpallur fitues, më ka ftuar komuna dhe e kemi nënshkruar kontratën, kontratën në fjalë në emër të komunës e ka nënshkruar menagjeri i prokurimit Mustafë Emmini, ndërsa në emër të operatorit “...” nga .., e kam nënshkruar unë në emër të firmës. Sipas kësaj kontrate unë kam pasur afat të caktuar për sjelljen e inventarit në objekt të komunës, e që më duket se afati për sjelljen e këtij inventari ka qenë 30 ditë, mirëpo unë kam kontaktuar me menagjerin e zyrës së prokurimit, i cili më ka thënë se mallin nuk kemi ku me lënë. Unë diku menjëherë pas 3 ditëve nga dita e nënshkrimit kam menduar që komunës t’ia dërgoj inventarin, me qëllim që nga komuna t’i marr të hollat për të njëjtin, sepse afati i fundit i pagesave, ka qenë 24 dhjetor 2012, menagjeri i prokurimit më ka thënë se nuk kem vend ku me lënë inventarin dhe në momentin kur të krijohen kushtet do të njoftoj. Me datë 10.12.2012, menagjeri i zyrës së prokurimit më ka ftuar në zyre përmes telefonit, dhe më ka treguar se duhet me bërë një aneks kontratë dhe ka kërkuar garancion bankar prej meje dhe më ka thënë se duhet ta sillni garancionin bankar e pastaj të nënshkruani aneks kontratën. Unë brenda ditës e kam siguruar garancionin bankar të njëjtën ditë por nuk më kujtohet se në çfarë vlere dhe e njëjta gjindet në dosjet e tenderit, kur e kam nënshkruar aneks kontratën ka qenë prezentë edhe kryetari i komunës S. M., ndërsa menagjeri i prokurimit më ka thënë se për 2-3 muaj, duhet t’ua sjellësh inventarin, brenda këtij afati kohor e kam punuar inventarin dhe vazhdimisht kam kontaktuar me M. E., dhe me informonte se ende nuk jemi gati për pranimin e inventarit dhe në aneks kontratë cekej se kur të jetë e gatshme komuna për pranimin e mallit, ju njoftojmë përmes emailit, kam vazhduar me punimin e inventarit e meqë komuna nuk ishte gati për pranim, jam detyruar që atë inventar ta shes me një çmim shumë më të ulët se sa ishte bërë në marrëveshje të tenderit. Të njëjtin material-inventar, pesë herë e kam punuar, e sipas mendimit tim se prej gjithë kësaj, fitues është Komuna e Kllokotit, e që deri në këtë moment është dorëzuar në komunë, megjithatë objekti i komunës nuk është funksional, në momentin kur kryetari i komunës S. S., pasi që e ka pranuar detyrën e kryetarit, kam shkuar për t’ua uruar në zyre pozitën dhe më ka pyetur se a e ke inventarin për objektin e ri të komunës, unë atij i kam thënë se po e kam dhe i kam thënë se a po don me ta sjellë në komunë, por siguroma vendin. Ai më është përgjigjur se kur të jem gati, unë të thirrri dhe na sjell inventarin, kam pritur një kohë, por nuk kam pas ftesë nga ana e kryetarit të komunës, por kam komunikuar edhe përmes shkresave të cilat janë në shkresat e lëndës, sepse unë në depon time, kam pasur tavolina të mëdha, nuk kam pasur vend dhe më është dashur me shit me çmim të ulët, i njëjti tender me furnizim me inventar ka qenë edhe me Komunën e Ranillukut, Vitisë dhe Graçanicës. Është e vërtetë se një komision i Komunës së Kllokotit ka ardhur te firma në ..., por i njëjti fare nuk ka hyrë brenda në lokal të firmës, unë nuk kam qenë prezent atë ditë ata kur kanë ardhur, dhe se të njetit kanë ardhur te firma ime vetëm atëherë kur u’a kam bërë një shkresë dhe u’a kam dorëzuar në komunë, e përmes së cilës nga komuna kam kërkuar 500 euro tjera për inventarin që kam qenë duke e mbajtur në magacinë. Me komisionin në fjalë atë ditë nuk jam takuar, ata e kishin lënë një letër në firmën time, në të cilin më kishin njoftuar se të nesërmen do të vijnë te firma ime, unë atyre iu kam thënë me telefon se unë e grumbulloj mallin në magacinë e pastaj ju vini, ditën kritike kur ka ardhur komisioni në firmën time ata më kanë kontaktuar në telefon dhe unë atyre ju kam thënë se kur ta grumbulloj mallin ,atëherë vini. Komisioni në fjalë te firma ime kanë qenë vetëm një here, dhe më nuk kanë ardhur, unë anëtarëve të komisionit nuk ju kam thënë se nuk e kam inventarin në depo, por të njëjtin u’a siguroj nëpër magacina me të cilat kam bashkëpunim, sepse unë nuk i punoj të gjithë inventarin që ka qenë i specifikuar në tender.

Unë inventarin për herë të parë Komunës së Kllokotit i’a kam dorëzuar gjatë vitit 2018, dhe pasi prokurori i shtetit i’a dorzoi kopjen e dorëzimit të inventarit, i akuzuari deklaroi: po, kjo është data 14.01.2018, këtë datë nuk e kam dorëzuar komplet inventarin por diku 90% te

inventarit, sipas specifikacioneve, materialin në tërësi nuk kam mundur t'a dorëzoj për shkak se fotelet janë porositur nga importi nga jashtë. Aneks kontratën e kemi bërë pas 5 ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës, aneks kontratën e ka nënshkruar kryetari i komunës, ndërsa atë kryesoren menagjeri i prokurimit, sipas mendimit tim, aneks kontratën nuk ka guxuar t'a nënshkruaj menagjeri i prokurimit, meqë për nënshkrimin e kontratës, ma i rëndesishëm ka qenë kryetari i komunës. Sipas mendimit tim munden me u bërë edhe 5 aneks kontrata tjera, e të cilat janë pjesë përbërse të kontratës kryesore dhe nuk kanë nevojë për numër tjetër të protokollit, sepse numri i tenderit- kontratës kryesore, bartet te aneks kontrata. Unë kam bërë faturë për me u bërë pagesa e inventarit, normal fatura duhet të bëhet pasi të dorëzohet malli-inventari, në këtë rast bazuar në marrëveshjen sipas aneks kontratës, e kam bërë faturën, asnjë komision nuk ka qenë te magacina ime, para se të bëhet pagesa e inventarit, sepse unë nuk mbajë mall rezervë në magacinë edhe përkundër faktit që e kam fituar tenderin, sepse sipas kontratës kam pas afat për furnizim prej 30 ditësh. Ne në rastin konkret nuk kemi bërë procesverbal për pranim-dorëzim të mallit, sepse e kemi pas në aneks kontratë, është e vertetë se unë e kam dorëzuar faturën pa e dorëzuar mallin, unë jam pronar i firmës "...", sipas mendimit tim unë kam mundur t'a dorëzoj faturën edhe përkundër faktit edhe pse inventarin nuk e kam dorëzuar, pasi që kemi bërë marrëveshje në aneks kontratë. Njohuri lidhur me ekzistimin e aneks kontratës përveq kryetarit të komunës S. M. ka pas edhe menagjeri i prokurimit, M. E., tani i ndjerë, ndërsa nuk ka qenë askush tjetër. Unë kam pasur punë vetëm me menagjerin e zyrës së prokurimit dhe askush nuk më ka pyetur se unë ju kisha treguar. Për herë të fundit edhe atë para 30 ditëve kam pranuar shkresën nga ana e Komunës së Kllokotit, për sjelljen e inventarit edhe atë me email, por fizikisht nuk e kam, ndërsa më herët nuk kam pas asnjë kërkesë nga ana komunës për sjelljen e inventarit. Unë kam shkuar te kryetari i komunës S. S., kur kam dëgjuar që ka iniciuar procedurë penale ndaj nesh dhe e kam pyetur se për çfarë arsye keni iniciuar procedurë penale, dhe ju jeni në dijeni se inventari për objektin e ri të komunës është te unë në depo, dhe ai më ka thënë se kur na duhet inventari të lajmëroj, ndërsa në kohën kur kemi dashur ne ta dërgojmë inventarin, ai më ka thënë se nuk ka vend. Njëherë pata shkuar me kamion te komuna me mall, dhe atij i kam thënë se ku më lënë mallin, ai më ka thënë se nuk kemi vend, ktheje se kur të na duhet ne ju njoftojmë përmes emailit. Komisioni i komunës ka qenë tek unë, pasi që unë pata shkuar dhe biseduar me kryetarin S. S., ma konkretisht unë kam kërkuar nga komuna qira mujore në shumën prej 500 euro, me rastin e shpalljes së tenderit si dhe nënshkrimit të kontratës, së bashku me dosje ka qenë edhe specifikacioni për inventar për objektin e ri të komunës. Nga materiali- inventari sipas specifikacionit të tenderimit, ne gati gjysmën e materialit e prodhojmë vet, gjysmën tjetër të materialit të cilin unë nuk e kam prodhuar në firmën time, nuk e kam porositur për shkak se ka qenë marrëveshja në aneks kontratë nga dita kur komuna kërkon përmes emailit për sjelljen inventarit, keni afat 15 ditë. Nga pjesa e inventarit të dorëzuar në komunë, në sasinë prej 90 %, pjesën dërrmuese të këtij inventari e kam prodhuar unë, ndërsa një pjesë tjetër e kam porosit, gjegjësisht ka ardhur nga importi që e kam bërë porosinë, 10 % i mbetur i inventarit është porositur nga Kina, e që unë bashkëpunoj me kompaninë e cila e sjell mallin prej Kinës, e që këtë mund t'a dëshmoj edhe përmes faturës që e kam marr mallin prej tij, 10 % e mbetur unë nuk e kam dorëzuar me dt. 14.01.2018, sepse nuk kam pas mundësi edhe atë për shkaqe financiare. Me rastin e dorëzimit të pjesës së fundit të inventarit edhe atë 10 % të inventarit që i është dorëzuar Komunës së Kllokotit, të premtën e kaluar, nuk kemi hartuar asgjë me shkrim ngase komuna ka thënë se duhet të formojmë komisionin për pranim-dorëzim të inventarit. Unë e kam pasur fletëdërgesën me veti me rastin e dorëzimit të mallit por të njëjtën nuk e kam dorëzuar pasi që jemi marrë vesh që të formohet komisioni e pastaj të dorëzohet. Inventarin e mbetur prej 10 %, të sasisë së përgjithshme e kam dorëzuar me dt. 15.02. 2019, në komunë, në komunë kanë qenë dy punëtor për me zbrast mallin dhe aty ka qenë S. M., tani nënkryetar dhe se të njejtin e kemi dorëzuar brenda në komunë ku ndodhet inventari tjetër, tani kryetar është

B. D., unë deklaroja edhe më parë se aneks kontratën e kam nënshkruar me ish-kryetarin e komunës S. M.

4.Fjalët përfundimtare të palëve

Prokurori i shtetit A.K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: gjatë shqyrtimeve gjyqësore është vërtetuar gjendja faktike dhe fajësia e të akuzuarve: S. M., për shkak të veprës penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, Z. S., S. S. dhe N. P., për shkak të veprës penale, keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe E. A., për shkak të veprës penale, keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit në vazhdim të fjalës së tij ka deklaruar se nuk është kontestues fakti se të pandehurit e lartëcekur me dashje kanë kryer veprat penale që u'a vënë në barrë aktakuza, e që kjo është vërtetuar edhe në bazë të veprimeve të cilat ata i kanë ndërmarr, përmes të cilave e kanë bërë të mundur që të paguhet inventari i Komunës së Klllokotit, ende pa u dorëzuar në komunë, duke dorëzuar dokumente fiktive, kinse është dorëzuar malli, ndërsa i akuzuari E. A. ka hartuar fatura fiktive për të përfiturar të hollat për mallin të cilin nuk e kishte dorëzuar. Se qëllimi i të pandehurit S.M. ishte që të përfitojë çfardo dobie për vete apo personin tjetër, apo t'i shkaktoj dëm personit tjetër, duke tejkuluar me dashje kompetencat dhe duke shkelur detyrat e tij të domosdoshme të përcaktuara me ligj. Sa i përket të akuzuarit E. A. edhe pse në fund shqyrtimit gjyqësorë kinse i njejtë e ka dorëzuar inventarin, kjo mund të vlerësohet nga gjykata se i njejtë e ka bërë nga frika se do të shpallet fajtor për veprën penale të cilën i'a vë në barrë aktakuza. Sa i përket të pandehurëve: Z. S., S. S. dhe N. P., në cilësinë e anëtarëve të komisionit për pranimin e inventarit të Komunës së Klllokotit, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin e tyre zyrtar, në bashkëkryerje me qëllim që të përfitojnë çfardo dobie për vete ose personin tjetër apo t'i shkaktojnë dëm personit tjetër me dashje, kanë shkelur detyrat e tyre me ligj edhe atë duke pranuar inventarin e komunës, sipas vendimit 2890/1, të datës 14.12.2012, të njejtit edhe pse e kanë ditur se inventari fillimisht duhet të numrohet sipas specifikacionit të përshkruar në kontratë, i njejtë pranohet, edhe pse inventari sipas porosisë së komunës ende nuk ishte pranuar fare, me çka Komunën e Klllokotit e kanë dëmtuar në vlerë prej 29.330.00 euro. Andaj në fund Prokurori i Shtetit i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit e lartëcekur të shpallen fajtor dhe të dënohen me dënim meritor sipas KPRK-së, dhe gjatë matjes së dënimit gjykata të ketë parasysh rrethanat rënduese, dhe atë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale, mënyrën e kryerjes së veprave penale si dhe vendosshmërinë e tyre për kryerjen e veprave penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret parasysh sjellja e të akuzuarve gjatë zhvillimit të procedurës penale.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës së Komunës së Klllokotit Z. C. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Unë në cilësinë e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, përkatësisht Komunës së Klllokotit, nuk i bashkangjitem ndjekjes penale ndaj të akuzuarëve, e poashtu nuk paraqesim kërkesë pasuroro-juridike, nga fakti se neve si komunë me rëndësi është që inventari ka arrit dhe se i njejtë gjendet në objektin e ri të komunës, dhe se për këtë çështje për inventar komuna ka hartuar procesverbal dhe ka konstatuar se i gjithë inventari ka arrit më komunë.

Mbrojtësi i të akuzuarit S. M. av... në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Gjatë shqyrtimeve gjyqësore ndaj të mbrojturit tim S. M. me asnjë provë të vetme nuk janë vërtetuar tezat e aktakuzës, e poashtu përfaqësuesi i aktakuzës nuk ka arritur t'i vërtetojë me asnjë provë veprimet inkriminuese, të përshkruara si në aktakuzë edhe atë lidhur me mospërmbushjen e kontratës, përkatësisht dëmtimin e buxhetit të komunës në vlerë prej **29.330.00 euro**. Poashtu mbrojtja konsideron se në të gjitha fazat e procedurës penale si ato të hetuesisë dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë, me dëgjimin e dëshmitarëve, administrimin e provave tjera, si dhe

marrjen në pyetje të akuzuarin, nuk është vërtetuar fajësia e S. M., për veprën penale për të cilën ngarkohet, meqë aktakuza nuk gjeti mbështetje faktike dhe ligjore, ngase i mbrojturi im është vërtetuar se nuk ka pasur për qëllim përfitimin material për vete apo personin tjetër, e as që ka përfituar në rastin konkret dhe se qëllimi i tij ka qenë i mirë dhe në favor të Komunës së Klllokotit. Poashtu pas shqyrtimit gjyqësorë u vërtetua se komuna ka pranuar inventarin e porositur sipas kontratës, i cili i është dorëzuar tërësisht, kështu që Komuna e Klllokotit, tani nuk është e dëmtuar, andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin S. M. t'a lirojë nga aktakuza për veprën penale keqpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, meqë nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari S. M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, se është e vërtetë se kam pasur problem me pranimin e inventarit dhe në bazë të rrethanave dhe kushteve që kemi pasur me plotë përgjegjësi deklaroj se askujt nuk kam dasht t'i shkaktoj ndonjë të keqe dhe të kem të gjithë infrastrukturën në komunë. Konsideroj se nuk kemi keqpërdor asgjë dhe se këta të akuzuar janë punëtor të ndershëm dhe të vlefshëm të komunës.

Mbrojtësja e të akuzuarit Z.S. av... në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit Z. S., për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 lidhur me nenin paragrafin 1 e nenin 31, të KPRK-së, të cilën aktakuzë, PTH e ka elaboruar gjatë shqyrtimeve gjyqësore të kësaj çështje penalo-juridike. Pas analizimit të të gjitha provave si në procedurën parapenale- fazën e hetimit dhe shqyrtimeve gjyqësore, provat e administruara nga të gjitha palët, duke përfshirë si ato materiale, personale si dhe provat ndihmëse të cilat janë shqyrtuar gjatë këtij procesi gjyqësorë, vie në përfundim se nuk është vërtetuar teza e aktakuzës me numër, PP.I.nr.194/15 e datës 22.12.2015. Andaj meqë pas administrimit të provave materiale në shqyrtimet gjyqësore nuk është vërtetuar se i mbrojturi im ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet edhe atë duke ardhur në përfundim se veprimi i tij, nuk ndërlidhet për veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj i propozoj gjykatës që për të akuzuarin Z. S., të bie aktgjykim lirues në pajtim me nenin 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-së.

I akuzuari Z. S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e mbështesë në tërësi fjalën e avokates, megjithatë dëshiroj të theksoj se në tërësi e kundërshtoj fjalën e prokurorit të shtetit, sepse unë me veprimet e kryera si antarë i komisionit, për pranimin e inventarit, nuk kam pasur asnjë qëllim përfitimi për vete apo dikënd tjetër, e as t'i shkaktoj dëm ndokujtë, dhe se deri te dhënia e nënshkrimit për pranimin e inventarit e kam bërë për faktin se i kam besuar menaxherit të zyrës së prokurimit të Komunës së Klllokotit.

Mbrojtësi i të akuzuarit S. S., av.... në fjalën përfundimtare ka deklaruar: të akuzuarin S. S. nga Klllokoti, aktakuza e PTHDKR, e ngarkon për veprën penale, keqpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-së. Gjatë procedurës paraprake-fazës hetimore, si dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura në këtë gjykatë me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se i mbrojturi im të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Poashtu gjatë administrimit të të gjitha provave materiale nuk është vërtetuar se i akuzuari S. S. me veprimet e veta, lidhur me pranimin e inventarit të Komunës së Klllokotit sipas vendimit 2890/1 të datës 14.12.2012, në asnjë mënyrë nuk ka përfituar çfardo dobie për vete apo për personin tjetër, andaj nuk qëndrojnë pretendimet e aktakuzës se i mbrojturi im, përkatësisht i akuzuari S. S, që duke shfrytëzuar detyrën apo

autoritetin zyrtar të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Andaj meqë nuk u vërtetua se i akuzuari S. S. ka kryer veprën penale për të cilën pretendon organi i akuzës, kërkoj nga gjykata që në pajtim me nenin 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-së të njejtin ta liroj nga akuza.

I akuzuari S. S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe se nuk kam asgjë të shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarës N. P., av... ka deklaruar: unë fjalën time përfundimtare e kam përgatitur me shkrim, dhe të njejtën i'a dorëzoi trupit gjykues dhe prokurorit të çështjes, megjithatë dëshiroj që fjalën përfundimtare ta elaburojë verbalisht. Sipas aktakuzës lëndore, PP.I. nr.194/2015 të datës 22.12.2015, e akuzuara N. P. është akuzuar për veprën penale keqpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-së. Siç dihet e akuzuara N. P. së bashku me të akuzuarit Z. S. dhe S. S. akuzohen sepse në cilësinë e antarëve të komisionit për pranimin e inventarit të komunës së Klllokotit, duke shfrytëzuar pozitën apo autoritetin zyrtar, në bashkëkryerje, me qëllim që vetit apo personit tjetër t'i sjellin çfardo dobie, apo t'i shkaktojnë dëm personit tjetër, me dashje kanë shkelur detyrat e përcaktuara me ligj. Mirëpo gjatë administrimit të provave nuk është vërtetuar se e akuzuara N. P. edhe përkundër faktit që në cilësinë e antares së komisionit për pranimin e inventarit të komunës, sipas vendimit nr.2890/1 të datës 14.12.2012, për vërtetimin e drejtë të gjendjes reale lidhur me përmbushjen e kontratës në mes të Komunës së Klllokotit dhe firmës NTP “.”, ashu që me datë 17.12.2012, nënshkruan raportin me nr.2897/1 për pranimin e mobileve për zyre, kinse të njejtin e kanë pranuar dhe se Ministria e Pushtetit Lokal mund ta bëjë pagesën për porosinë e inventarit komunal, edhe përkundër faktit që materiali nuk ishte pranuar fare me çka Komunën e Klllokotit e kanë dëmtuar në vlerë prej 29,330,00 euro, dhe se me këtë sipas prokurorisë kanë kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-së. Gjykata në shqyrtimet e mbajtura gjyqësore ka administruar të gjitha provat materiale, megjithatë me asnjë provë të vetme nuk është provuar se e akuzuara N. P. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj i propozoj gjykatës që bazuar në dispozitën e nenit 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-së të bie aktgjykim lirues në mungesë të provave.

E akuzuara N. P. deklaron: e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit tim, megjithatë dëshiroj të theksoj, se edhe sot deklaroj me bindje të plotë nuk kam menduar që të nënshkruaj diçka me qëllim që të përfitoj dikush apo të pësoj dikush tjetër, qëllimi kryesor i imi ka qenë, që vetëm komuna të paiset me inventar, ndërsa qëllim tjetër nuk kam pasur, prandaj e ndjej veten plotësisht të pafajshme.

I akuzuari E. A. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: mbetem në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, të dt.12.04.2019, dhe nuk kam tjetër qka të shtoj.

5.Elementet e veprës penale

Keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422 paragrafi 1 të KPRK-së, kryhet nga personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfardo dobie për vete ose personin tjetër, apo që t'i i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkelë të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite.

6.Konstatimet e trupit gjykues-vlerësimi dhe analizimi i provave

Trupi gjykues, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, në pajtim me nenin 361 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së, shqyrtoj dhe administroj të gjitha faktet dhe provat materiale, vlerësoi secilën provë një nga një, e pastaj të gjitha së bashku dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të gjithanshëm gjeti se: Komuna e Kllokotit, përmes procedurave të tenderimit lidhur me inventarin e porositur, përkatësisht mobilet për zyre të specifikuara, edhe atë sipas kontratës me nr. 2863/1, të datës 05.12.2012, të lidhur në mes Komunës së Kllokotit dhe firmës NTP “..”, nga .. me pronarë, tani të akuzuarin E. A., nuk kishte arritur që në afatin e paraparë si në kontratë të bëjë furnizimin me inventar-paisje, për shkak se objektin e ri të komunës nga kryersi i punëve nuk ishte kryer sipas planit dinamik të paraparë me kontratë. Po ashtu gjykata konstaton se ish – kryetari i komunës, tani i akuzuari S. M., përmes vendimit me nr.2890/1 të datës 14.12.2012, kishte formuar komisionin për pranimin e inventarit për objektin e ri të Komunës së Kllokotit, në përbërje të antarëve të komisionit – punëtorëve të komunës, tani të akuzuarëve Z. S., kryetar i komisionit, S. S. dhe N. P., antarë të komisionit, kanë nënshkruar raportin me nr.2897/1 të datës 17.12.2012, kinse inventari – mobilet për zyre ishin pranuar, sipas kontratës së nënshkruar nga Komuna e Kllokotit dhe pronarit të firmës, tani i akuzuari E. A. Gjykata, konstatoi edhe faktin se financimi i objektit të ri të Komunës së Kllokotit, ishte bërë nga ana e Unionit Evropian, e që firma përkatësisht, kryersi i punimeve, i cili e kishte fituar tenderin për ndërtimin e ri të objektit të komunës, nuk i kishte kryer punët e ndërtimit sipas planit dinamik të paraparë me kontratë. Kështu që kishte pasur ndërprerje të tërësishme të punimeve të objektit në fjalë, për shkak të mosmarrëveshjeve të Unionit Evropian – financues i projektit dhe kompanisë ndërtuese nga Kroacia, e cila e kishte fituar tenderin për ndërtimin e Komunës së re të Kllokotit, dhe se këto mosmarrëveshje kishin zgjatur deri sa gjykata kompetente ka vendosur për të njejtat. Komuna e Kllokotit në të njejtën kohë kishte marrë një sasi të mjeteve nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Administrimit Lokal në vlerë prej 30.000 €, për të siguruar inventarin – mobilet për zyre për objektin e ri të Komunës së Kllokotit, pastaj ishte shpallur tenderi për furnizim për inventarin – mobilet për zyrën e komunës së re, ishte përzgjedhur operatori ekonomik NTP “..”, nga ..., duke u nënshkruar kontrata në mes komunës dhe pronarit të operatorit ekonomik, NTP “..”, nga .., tani i akuzuari E. A.. Meqë punët e ndërtimit të objektit të ri të komunës ishin ndërprerë dhe në pamundësi të dërgimit të inventarit në fjalë dhe mos gadishmërisë së përgjegjësive të Komunës së Kllokotit, për të pranuar inventarin, ishte hartuar dhe ishte nënshkruar edhe një aneks kontratë me datën 10.12.2012, nga ana e ish – kryetarit të komunës, tani të akuzuarit S. M. në njërin anë dhe pronarit të NTP “..” nga .., tani të akuzuarit E.A. në anën tjetër. Përmes së cilës palët ishin dakorduar që në momentin kur komuna të jetë e gatshme për të pranuar inventarin e porositur, pronari i kompanisë, fituesi i tenderit që brenda afatit prej 10 deri 15 ditësh, t’u dërgojë inventarin sipas specifikacionit të tenderit. Meqë sërish punimet rreth ndërtimit të objektit të ri të Komunës së Kllokotit kishin ngecur, inventari i porositur nga komuna në fjalë kishte arritur të dorëzohet me 19.04.2018, ndërsa pjesa tjetër e mbetur e inventarit ishte dorëzuar me datën 14.02.2019, e që inventari i porositur nga ana e komunës në vlerë prej 29.330.00 euro, i ishte dorëzuar Komunës së Kllokotit edhe atë në bazë të raportit për pranim – dorëzim të inventarit të hartuar nga ana e komisionit të formuar me vendimin e kryetarit të komunës aktual, B. D., e të cilit kanë konstatuar se dorëzim – pranimi i inventarit është bërë në bazë të kontratës nr.2863/1 të datës 05.12.2012.

Pretendimeve të prokurorit të shtetit se të akuzuarit: S. M., ka kryer veprën penale, keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar, në nenin 422 parag. 1 të KPRK-së, Z. S., Strahinja S. dhe Ne. P., kanë kryer veprën penale, keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 parag. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe E. A. ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 parag. 1 të KPRK-së, gjykata i’a fali besimin sepse pas dëgjimit të dëshmitarëve, administrimit të provave të theksuara si më lartë, është vërtetuar

se të akuzuarit e sipërtheksuar edhe atë S. M., me dashje përkatësisht, me dije ka keqpërdor pozitën apo autoritetin zyrtar, ashtu që në cilësinë e personit zyrtar, ish kryetarit të komunës, duke e shfrytëzuar detyrën si dhe autoritetin e tij zyrtar i tejkalon kompetencat e tij, e me qëllim të përfitimit të çfardo dobie për vete apo personin tjetër, si dhe duke i shkaktuar dëm personin tjetër në rastin konkret Komunës së Klllokotit, e formon komisionin prej tre anëtarëve puntorë të komunës në përbërje të ..- kryetar, S.. S.. dhe N. P.-antarë, sipas vendimit me nr.2890/1 të dt.14.12.2012, duke i rekomanduar që në mënyrë fiktive, të nënshkruajnë raportin, kinse inventari i porositur është dorëzuar në komunë nga ana e kontraktuesit edhe përkundër faktit që inventari nuk kishte arritur fare në komunë, ndërsa pas nënshkrimit të raportit nga ana e komisionit të shënuar si më lartë, i akuzuari S. M., i kishte rekomanduar puntorët e buxhetit dhe financave që operatorit ekonomik, përkatësisht pronarit të firmës “..” , E.A.. t’i bëhet pagesa në shumën prej 29,330.00 euro. Se i akuzuari S. M. kishte keqpërdorur pozitën dhe autoritetin e tij zyrtar, nuk ishte kontestuese për gjykatën për faktin se edhe me veprimin tjetër, edhe atë me rastin e nënshkrimit të aneks kontratës të dt. 10.12.2012, të bërë në mes tij në cilësinë e ish kryetarit të komunës, në njërin anë dhe pronarit të operatorit ekonomik – firmës “..” nga .., E. A., kontratë kjo e cila fare nuk ishte e protokoluar nga zyra e pranimit, për të cilën poashtu S. M., në cilësinë e ish kryetarit të komunës nuk ka qenë kompetent të nënshkruaj aneks kontratën në fjalë për shkak se në atë kohë, Komuna e Klllokotit ka pasur personin përgjegjës dhe kompetent e të kualifikuar që ti nënshkruaj të gjitha kontratat përkatësisht aneks kontratat, e që në atë kohë menaxher i zyrës së prokurimit ishte M. E., pra edhe në rastin konkret është bërë anashkalim i mexhaerit të zyrës së prokurimit. Ndërsa të akuzuarit: Z. S., S. S. dhe N. P., poashtu në cilësinë e personave zyrtar të Komunës së Klllokotit, me ndërmarrjen e veprimeve të tyre, duke qenë të informuar mirë se janë caktuar anëtarë të komisionit nga ana e të akuzuarit S. M., ish kryetar i komunës, për të nënshkruar një raport lidhur me pranimin e inventarit të Komunës së Klllokotit, edhe pse e kanë ditur se inventari fare nuk ka arritur në komunë, në mënyrë fiktive e nënshkruajnë raportin me nr.22897/1 për pranimin e inventarin, mobileve për zyre, kinse inventari në fjalë është dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “..” nga ... dhe se i njejtë është dorëzuar në komunë, pra të akuzuarit në fjalë duke e ditur mirë faktin se po nënshkruajnë një raport, i cili duhet të nënshkruhet në mënyrë fiktive pa u përmbushur objekti bazë i kontratës, siq ka qenë pranimi i inventarit të njejtë një gjë të tillë e kanë bërë. Gjykata poashtu konstatoi faktin se edhe i akuzuari E. A., me veprimet e tij ngjajshëm si dhe të akuzuarit e tjerë ka keqpërdor pozitën ose edhe autoritetin zyrtar, në atë mënyrë që edhe përkundër faktit që inventarin e porositur nga ana e komunës sipas kontratës bazë me nr.2863/1 të dt.05.12.2012 , nuk ia kishte dorëzuar Komunës së Klllokotit, duke u bazuar në raportin fiktiv të komisionit për pranimin e inventarit, i harton faturat me çmimin si në kontratë për furnizim me inventar, duke e sjellur në lajthim komunën, gjëja se inventari i është dorëzuar të njejtës, me qëllim që të pranojë të hollat në shumën prej 29,330.00 euro, gjëja se inventari i është dorëzuar komunës. Poashtu i akuzuari E. A. ka bërë veprimin tjetër duke keqpërdor pozitën apo autoritetin e tij zyrtar, ashtu që ka nënshkruar aneks kontratën të dt.10.12.2012, me ish kryetarin e komunës tani të akuzuarin S. M., duke mos e protokoluar të njëjtën nga zyra e pranimit, e poashtu duke anashkaluar menaxherin e zyrës së prokurimit i cili ka qenë kompetent për të nënshkruar edhe aneks kontratën. Se të akuzuarit e sipërtheksuar i kanë shkaktuar dëm Komunës së Klllokotit, për gjykatën nuk ka qenë kontestues as fakti, sepse edhe në bazë të ekspertizës financiare plotësuese të dt.16.01.2019 është vërtetuar se përfitimi i llogaritur nga mbajtja e mjeteve mbi 5 vite nga pronari NTP “..” nga .., Komunën e Klllokotit e kanë dëmtuar në shumën prej 2,790.84 euro.

Nga të gjitha këto që u thanë më sipër, gjykata erdhi në përfundim se te të akuzuarit e lartëcekur ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale për të cilat akuzohen dhe se për të njejtat janë përgjegjës dhe fajtor. Andaj gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe i gjykoj me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

7.Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-së , i detyron të akuzuarit: S. M., Z. S., S. S., N. P. dhe E.A., që në mënyrë solidare, Komunes së Klllokotit t’ia paguajnë shumën prej **2.790.84 euro**, të shkaktuara me veprën penale të keqpërdorimit të pozitës ose autoritetit zyrtar si në pikat **I, II, dhe III**, të aktakuzës, tani aktgjykimit edhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata për shpenzimet e procedurës penale, për të akuzuarit, ka vendosur në pajtim me nenin 453 paragrafi 1, në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nënparagrafi 2.6 të KPRK-së, ndërsa për taksën në emër të kompensimit të viktimave të krimit, ka vendosur në kuptim të nenit 39 paragrafi 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, nr.05/L-036.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.174/2019, më 21.12.2020

Zyrtarja ligjore
Zahide Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues
Islam Thaçi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.